

DITARI MUJOR

**QERSHOR
2025**

PROGRAMI MË I MADH PËR PUNËSIMIN E TË RINJVE NË SHQIPËRI – 63.5 MILIONË EURO NGA BE



Në Kuvend për projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, në kuadër të IPA III, për Programin Operacional Shumëvjeçar për Punësimin e të Rinjve 2024–2027. Me një vlerë prej 63.5 milionë euro, ky është programi më i madh i dedikuar ndonjëherë punësimit të të rinjve në Shqipëri. Ai përfaqëson një hap konkret drejt përmbushjes së standardeve sociale dhe ekonomike të Bashkimit Evropian, duke ndërtuar ura reale për integrimin evropian. Programi synon të zbatojë Garancinë Rinore, duke siguruar që çdo i ri i papunë, jashtë arsimit ose formimit profesional, të marrë një ofertë konkrete për punësim, trajnim apo arsimim brenda 4 muajve nga regjistrimi në sistemin e punësimit. Ky është një investim i drejtpërdrejtë në potencialin e rinisë shqiptare dhe një garanci për një të ardhme më të sigurt, më të aftë dhe më të drejtë për të gjithë.

MUZEU BESA DHE PROJEKTET E MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT NË QENDËR TË FESTIVALIT “BUKË, KRIPË E ZEMËR”

Projekti i Muzeut BESA, që nderon mikpritjen dhe guximin e familjeve shqiptare që shpëtuan hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore, u prezantua në Festivalin e Arkitekturës “Bukë, Kripë e Zemër” në Tiranë, nën kujdesin e Kryeministrit Edi Rama. Ky muze është një ndër investimet më domethënëse të Qeverisë për ruajtjen e kujtesës historike dhe promovimin e vlerave njerëzore. Në festival u prezantuan gjithashtu projekte të shumta të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, që përfshijnë muze, teatro, biblioteka e qendra komunitare, të gjitha pjesë e një vizioni për të transformuar infrastrukturën kulturore të vendit. Në bashkëpunim me partnerë vendas e të huaj, këto projekte synojnë të krijojnë hapësira funksionale, përfshirëse dhe frymëzuese për komunitetin.



SHQIPËRIA NË VIVATECH PARIS 2025, NJË QENDËR RAJONALE PËR TEKNOLOGJINË DHE INOVACIONIN



Në edicionin e këtij viti të VivaTech Paris 2025, Shqipëria u prezantua si një nyje e rëndësishme rajonale për teknologjinë, inovacionin dhe investimet e qëndrueshme. Projekte strategjike si TEDA Tirana dhe Durana Tech Park ngjallën interes të madh nga investitorë ndërkombëtarë, duke e vendosur vendin në hartën evropiane të zhvillimeve të reja teknologjike. Përmes Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), u zhvilluan dhjetëra takime me kompani lider në fusha si inteligjenca artificiale, greentech dhe transformimi digjital, duke hapur rrugën për bashkëpunime konkrete dhe investime me impakt të qëndrueshëm. Gjithashtu, u konfirmua vullneti për thellimin e partneritetit Shqipëri–Francë në fushën e inovacionit dhe teknologjisë, duke hapur horizonte të reja për integrimin e vendit në ekosistemin digjital evropian.

FILMI SHQIPTAR RILIND – RESTAURIMI I KINOSTUDIOS DHE ARKIVIT TË FILMIT, NJË GUR THEMELI

Me përfundimin e punimeve restauruese në Ish-Kinostudio dhe në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit (AQSHF), Shqipëria hedh një hap të rëndësishëm përpara në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë së saj filmike. Restaurimi i fasadës historike të godinës së Ish-Kinostudios dhe përmirësimi i sistemeve elektrike e sanitare u realizuan në kuadër të programit EU4Culture, të implementuar nga UNOPS, duke respektuar vlerat arkitektonike të këtij Monumenti Kulture me rëndësi të veçantë për identitetin kombëtar. Ndërkohë, në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit, investimi në pajisje bashkëkohore ka përmirësuar ndjeshëm kapacitetet për restaurimin dhe digjitalizimin e fondit filmik shqiptar, duke siguruar një ruajtje më të mirë dhe një qasje më të gjerë për brezat aktualë dhe të ardhshëm.





tirana mikpritëse e #ALForum2025, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut

Tirana mirëpriti #ALForum2025, duke bashkuar mbi 1,000 pjesëmarrës nga 43 vende të rajonit dhe më gjerë. Në një kohë sfidash komplekse, forumi theksoi rëndësinë e dialogut të bazuar në dije, krijimtari dhe respekt të ndërsjellë si themelin për një të ardhme të qëndrueshme. Për tre ditë, kryeqyteti u shndërrua në një hapësirë ku kultura, arti, diplomacia dhe angazhimi qytetar bashkëpunuan për të forcuar partneritetin euro-mesdhetar mbi vlera njerëzore dhe solidaritet.

PRESHEVA, NË FOKUS TË BASHKËPUNIMIT PËR GJUHËN DHE KULTURËN SHQIPTARE



Në kuadër të Panairit të Parë të Librit Shqip në Preshevë, u zhvillua një vizitë zyrtare me Kryetaren e Komunës, znj. Ardita Sinani, dhe Ambasadorin e Shqipërisë në Serbi, z. Bardhyl Canaj. Kjo nismë përfaqëson një hap të rëndësishëm për forcimin e lidhjeve kulturore dhe mbështetjen ndaj komuniteteve shqiptare jashtë kufijve.

Përhapja dhe ruajtja e gjuhës shqipe si një pasuri kombëtare është një prioritet i përbashkët, ndërsa shkëmbimet institucionale dhe kulturore synojnë të nxisin bashkëpunim afatgjatë dhe të mbështesin identitetin kulturor e gjuhësor të shqiptarëve në rajon. Vizita shënon një angazhim të qartë për thellimin e marrëdhënieve dhe realizimin e projekteve të përbashkëta në fushën e kulturës, arsimit dhe inovacionit, në frymën e respektit, mirëkuptimit dhe përfshirjes.

LAJM HISTORIK – PËR HERË TË PARË, 1,253 FAMILJE NË 35 BASHKI PËRFITOJNË NGA PROGRAMI KOMBËTAR I STREHIMIT SOCIAL!

Një moment historik për politikat sociale në Shqipëri: 1,253 familje në nevojë në 35 bashki do të përfitojnë nga Programi Kombëtar i Strehimit Social, me një financim rekord prej afro 1 miliard lekësh nga buxheti i shtetit!

Zbatimi i projektit nis që në korrik-gusht 2025 dhe do të zgjasë për dy vite, duke sjellë përmirësim real të kushteve të jetesës, infrastrukturë rurale më të mirë dhe akses në shërbime jetike për mijëra qytetarë. Ky është hapi më i madh i ndërmarrë ndonjëherë në mbështetje të strehimit social, një investim që prek drejtpërdrejt jetën e familjeve shqiptare dhe afirmon angazhimin e qeverisë për një Shqipëri më të drejtë, më gjithëpërfshirëse dhe më humane.

SHQIPËRIA MODERNIZON MBROJTJEN E PRONËSISË INDUSTRIALE – DY PROJEKTLIGJE TË REJA SIPAS STANDARDEVE TË BE-SË

Zëvendësministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Sokol Duma, prezantoi në Komisionin për Çështjet Ligjore dy projektligje kyçe për modernizimin e kuadrit ligjor në fushën e pronësisë industriale.

Projektligji “Për Markat Tregtare” përputhet me legjislacionin e BE-së dhe synon mbrojtje më të fortë kundër abuzimeve, procedura të qarta për regjistrimin dhe njohjen e markave ndërkombëtare, si dhe masa për parandalimin e shkeljeve të të drejtave të markës.

Projektligji “Për Patentat, Modelet e Përdorimit dhe Çertifikatat e Mbrojtjes Shtesë” konsolidon mbrojtjen e shpikjeve dhe sjell për herë të parë rregullim për certifikatat e mbrojtjes shtesë, me fokus në sektorë strategjikë si farmaceutika dhe mbrojtja e bimëve.

Të dyja nismat forcojnë sigurinë ligjore, nxisin inovacionin dhe



RATIFIKIMI I VENDIMIT TË CEFTA-S PËR TREGTINË ELEKTRONIKE, HAPUR DREJT BASHKËPUNIMIT RAJONAL DHE INTEGRIMIT EUROPIAN



Projektligji për ratifikimin e vendimit të CEFTA-s për Tregtinë Elektronike, një nismë që synon të lehtësojë tregtinë digjitale në rajon përmes heqjes së barrierave në ofrimin e shërbimeve elektronike, forcimit të mbrojtjes së konsumatorëve, dhe harmonizimit të legjislacionit me atë të Bashkimit European.

Projektligji u prezantua nga zëvendësministria Blerta Rama, e cila theksoi rëndësinë strategjike të këtij hapi për zhvillimin ekonomik dhe digjital të rajonit. Përmes këtij vendimi, Shqipëria dhe vendet e tjera të CEFTA-s bëhen pjesë aktive në krijimin e një tregu të përbashkët digjital, duke përmirësuar qasjen në shërbime dhe duke rritur besimin e qytetarëve dhe bizneseve në transaksionet online.

Kjo nismë shënon një moment kyç për thellimin e bashkëpunimit rajonal dhe përshpejtimin e procesit të integrimit european, duke vendosur themelet për një ekonomi më të hapur, më të përfshirë dhe më të orientuar drejt të ardhmes.

SHQIPËRIA NË SUMMER DAVOS, KINË, MODELI I QËNDRUESHËM I TURIZMIT NË FOKUS



Në Forumin Ekonomik Botëror, Takimi Vjetor i Kampionëve të Rinj (Summer Davos) në Tianjin, Kinë, Shqipëria u përfaqësua në panelin kushtuar rolit të turizmit në rritjen ekonomike. U prezantua përvoja dhe vizioni për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit, që sot përbën mbi 20% të PBB-së dhe gjeneron rreth 270,000 vende pune të lidhura drejtpërdrejt e tërthorazi. Diskutimet theksuan mundësitë për të balancuar zhvillimin ekonomik me mbrojtjen e mjedisit, përmes investimeve të qëndrueshme, digjitalizimit dhe angazhimit të komuniteteve. Forumi shërbeu si një hap i mëtejshëm për forcimin e profilit të Shqipërisë si një destinacion turistik konkurrues dhe një ekonomi në rritje të qëndrueshme.

MIRATOHET NË PARIM MARRËVESHJA SHQIPËRI-SERBI PËR SIGURIMET SHOQËRORE

Është miratuar në parim Marrëveshja dypalëshe Shqipëri-Serbi për Sigurimet Shoqërore, një zhvillim i rëndësishëm që synon të garantojë të drejtat sociale të qytetarëve që punojnë ose kanë punuar në njërin prej dy vendeve. Kjo marrëveshje siguron njohjen e ndërsjellë të periudhave të sigurimit, kontributeve dhe përfitimeve sociale, duke i lehtësuar qytetarëve shqiptarë në Serbi dhe shtetasve serbë në Shqipëri aksesin në pensione dhe në skemat e tjera të mbrojtjes sociale. E negociuar në përputhje me standardet e Bashkimit European, kjo nismë është një hap i rëndësishëm drejt krijimit të një sistemi të mbrojtjes sociale pa kufij, në funksion të lëvizjes së lirë të punonjësve dhe garantimit të barazisë së trajtimit për të gjithë. Marrëveshja shpreh vullnetin për të forcuar bashkëpunimin rajonal, për të respektuar kontributin e punëtorëve në të dy vendet dhe për të avancuar në rrugën e integritit european dhe përfshirjes sociale të qytetarëve shqiptarë kudo që ndodhen.



MIRATOHET LISTA E ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE PËR EFEKT PENSIONI NË SIGURIMET SHOQËRORE



Është miratuar zyrtarisht lista e ish-ndërmarrjeve bujqësore që do të shërbejë për njohjen e periudhave të punës deri në vitin 1992, me qëllim lehtësimin e përfitimit të pensionit për shumë qytetarë që kanë punuar në këto ndërmarrje. Ky vendim përfaqëson një hap të rëndësishëm në zgjidhjen e problemeve të vjetra dokumentacioni, të cilat kanë penguar prej vitesh njohjen e periudhave të sigurimit për mijëra punonjës. Përmes kësaj mase, shmangen vonesat burokratike dhe evitohen proceset e gjata gjyqësore, duke ofruar një zgjidhje më të drejtë dhe humane për qytetarët që nuk kanë mundur të plotësojnë periudhën minimale të sigurimit. Nisma është rezultat i një bashkëpunimi ndërinstitutional mes Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), si pjesë e përpjekjeve për përmirësimin e sistemit të pensioneve dhe mbrojtjen e të drejtave të punonjësve të dikurshëm, të cilët kontribuan për dekada me radhë në zhvillimin rural të vendit. Ky vendim sjell drejtësi të vonuar për shumë familje shqiptare dhe afirmon vullnetin institucional për t'i dhënë zgjidhje çështjeve të trashëguara që prekin jetesën e qytetarëve.